



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.legjislacionishqiptar.gov.al

Nr.23

5 mars

2007

P Ë R M B A J T J A

Faqe

Vendim i KM nr.74, datë 17.2.2007	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi dhe rehabilitimi i segmentit rrugor Shkodër-Velipojë	379
Vendim i KM nr.77, datë 17.2.2007	Për një shtesë fondi, në buxhetin e vitit 2007, miratuar për Ministrinë e Shëndetësisë, për mbulimin e shpenzimeve, për kryerjen, jashtë vendit, të transplantit të veshkës, pranë qendrës spitalore universitare “Ibni Sina Hastanesi Sihhiye”, Ankara, Turqi, për disa shtetas	382
Vendim i KM nr.78, datë 7.2.2007	Për masën, kriteret dhe procedurat e përfitimit të një pakete të veçantë higjieno-sanitare, për invalidët paraplegjikë dhe tetraplegjikë	382
Vendim i KM nr.83, datë 17.2.2007	Për kriteret e ndërtimit me koncesion, të formës ROT/BOT, të termocentralit në Fier	383
Vendim i KM nr.84, datë 17. 2.2007	Për objektet e Korporatës Elektroenergjetike Shqiptare (KESH) sh.a., që nuk do të konsiderohen pjesë të sektorëve me rëndësi të veçantë	384
Vendim i KM nr.85, datë 17.2.2007	Për miratimin e procedurave të notifikimit të kuadrit ligjor tregtar, ekonomik dhe financiar, në Organizatën Botërore të Tregtisë	384
Udhëzim i MF nr.3, datë 26.2.2007	Për disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin nr.3, datë 30.1.2006 të Ministrit të Financave "Për tatimin mbi vlerën e shtuar"	392
Vendim i ERE nr.9, datë 21.2.2007	Për miratimin e rregullave dhe procedurave të certifikimit të prodhimit të energjisë elektrike nga burime të rinovueshme	392

VENDIM
Nr.74, datë 17.2.2007

PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMI DHE REHABILITIMI I SEGMENTIT RRUGOR SHKODËR-VELIPOJË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, pika 1, 20 e 21 të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private, për interes publik”, dhe të nenit 8 të ligjit nr.9464, datë 28.12.2005 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2006”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi dhe rehabilitimi i segmentit rrugor Shkodër-Velipojë.
 2. Shpronësimi të bëhet në favor të Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve.
 3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, që paraqitet në tabelën, që i bashkëlidhet këtij vendimi, për sipërfaqen 2 347 m² tokë/arë, të vlerësuar me çmimin 500 lekë/m², me vlerë të përgjithshme prej 1 173 500 (një milion e njëqind e shtatëdhjetë e tre mijë e pesëqind) lekësh, ullishtë, me sipërfaqe 240 m², me çmimin 500 lekë/ m² me vlerë të përgjithshme prej 120 000 (njëqind e njëzet mijë) lekësh; kullotë, me sipërfaqe 2 561 m² me çmimin 300 lekë/ m², me vlerë 768 300 (shtatëqind e gjashtëdhjetë e tetë mijë e treqind) lekë; drufrutorë, me vlerë 196 600 (njëqind e nëntëdhjetë e gjashtë mijë e gjashtëqind) lekë, me një vlerë të përgjithshme shpronësimi prej 2 258 400 (dy milionë e dyqind e pesëdhjetë e tetë mijë e katërqind) lekësh.
 4. Shpenzimet procedurale, në shumën 266 500 (dyqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e pesëqind) lekë, të përballohen nga Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve.
 5. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 2 258 400 (dy milionë e dyqind e pesëdhjetë e tetë mijë e katërqind) lekësh, të përballohet nga llogaria speciale, e krijuar si transfertë kapitale për t’u përdorur për shpronësimet.
 6. Shpronësimi të fillojë më 1.3.2007 dhe të përfundojë brenda 31.3.2007.
 7. Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve të bëjë likuidimin e pronarëve, brenda afatit të parashikuar në pikën 6 të këtij vendimi.
 8. Pronarët e përmendur në listën që i bashkëlidhet këtij vendimi, për të cilët është bërë shënimi “Plotësim dokumentacioni”, “Proces regjistrimi” dhe “Pretendim pronësie”, të kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin e plotë të pronësisë pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve. Deri në këto çaste paratë do të qëndrojnë të bllokuara në bankë.
 9. Ngarkohen Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit dhe Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

REPUBLIKA E SHQIPERISE
 MINISTRIA E PUNEVE PUBLIKE, TRANSPORTIT DHE TELEKOMUNIKACIONIT
 DREJTORIA E PERGJITHSHME E RRUCEVE

LISTA E PRONAREVE QE SHPRONESOHEN PER SHKAK TE REHABILITIMIT E NDERTIMIT TE RRUGES
SHKODER - VELIPOJE km 14-26

Lloji i pasurise se paluajtshme: are, ulishte dhe kullote (1-16)

Nr.	Emri	Pronari		ZK	Nr. pas.	Sip. Are m2	Sip. Ull. m2	Sip. Kull. m2	Cmimi lek/m2	Vlera lek	Drufrut. lek	Totali lek	Shenime
		Atesia	Mbiemri										
1	Nikoll Lek		Marku Marku	1075 Baks i Ri	797/25			919	300	275700		275700	Plotesim Dokumentacioni
2	Smajl Islam Mustafe Molle Bushe Beqir Lirije Arben Ornela Sullitane		Ramaj Ramaj Ramaj Ramaj Ramaj Ramaj Ramaj Ramaj Ramaj	1075 Baks i Ri	797/24			763	300	228900		228900	
3	Smajl Islam Mustafe Molle Bushe Beqir Lirije Arben Ornela Sullitane		Ramaj Ramaj Ramaj Ramaj Ramaj Ramaj Ramaj Ramaj	/ 1075 Baks i Ri	797/18			879	300	263700	16600	280300	Plotesim Dokumentacioni
4	Pal Armand	Mark Pal	Ujka Ujka	1075 Baks i Ri	308/5	778			500	389000	120000	509000	

5	Idriz	Adem	Ademi	1075 Baks i Ri 1075	690/1	120	500	60000	30000	90000	Proces Rregjistrimi
6	Fasli	Adem	Ademi	Baks i Ri	690/2	120	500	60000	30000	90000	Proces Rregjistrimi
7	Pashko		Jaku	Pulaj	883/1		500	47500		47500	Pretendim Pronesie
8	Dede	Gjeto	Kroi	Pulaj	883/17	240	500	120000		120000	Plotesim Dokumentacioni
10	Gjelosh		Sterkaj	Pulaj	883/18	255	500	127500		127500	Pretendim Pronesie
11	Tom		Deda	Pulaj	883/11	280	500	140000		140000	Plotesim Dokumentacioni
12	Kanto	Marash	Deda	Pulaj	883/12	160	500	80000		80000	Plotesim Dokumentacioni
13	Dede		Leka	Pulaj	1066/3	100	500	50000		50000	Pretendim Pronesie
14	Preke		Leka	Pulaj	1066/4	100	500	50000		50000	Pretendim Pronesie
15	Gjergj		Leka	Pulaj	1066/5	114	500	57000		57000	Pretendim Pronesie
16	Pashko		Leka	Pulaj	1066/6	225	500	112500		112500	Pretendim Pronesie
				SHUMA		2347	2561	2061800	196600	2258400	

VENDIM
Nr.77, datë 17.2.2007

**PËR NJË SHITESË FONDI, NË BUXHETIN E VITIT 2007, MIRATUAR PËR MINISTRINË
E SHËNDETËSISË, PËR MBULIMIN E SHPENZIMEVE, PËR KRYERJEN, JASHTË
VENDIT, TË TRANSPLANTIT TË VESHKËS, PRANË QENDRËS SPITALORE
UNIVERSITARE “IBNI SINA HASTANESI SIHHIYE”, ANKARA, TURQI, PËR DISA
SHTETAS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 21 e 27 të ligjit nr.8379, datë 29.7.1998 “Për hartimin dhe zbatimin e Buxhetit të Shtetit të Republikës së Shqipërisë” dhe të nenit 12 të ligjit nr.9645, datë 27.11.2006 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2007”, me propozimin e Ministrit të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ministrisë së Shëndetësisë, në buxhetin e miratuar për vitin 2007, në zërin “Shpenzime për mallra e shërbime”, t’i shtohet fondi prej 18 100 000 (tetëmbëdhjetë milionë e njëqind mijë) lekësh, për mbulimin e shpenzimeve, për kryerjen, jashtë vendit, të transplantit të veshkës, për disa shtetas.

2. Lejimin e Ministrisë së Shëndetësisë, që, me fondin prej 18 100 000 (tetëmbëdhjetë milionë e njëqind mijë) lekësh, të kryejë transplantin e veshkës për 12 shtetas pranë qendrës spitalore universitare “Ibni Sina Hastanesi Sihhiye”, Ankara, Turqi, përmes shoqërisë “Enar Saglik ve Egitim Hiz. Ltd.”, Ankara, Turqi.

3. Ky fond të përballohet nga fondit rezervë i Këshillit të Ministrave.

4. Ngarkohet Ministria e Shëndetësisë të negociojë dhe të lidhë kontratën me “Enar Saglik ve Egitim Hiz. Ltd.”, Ankara, Turqi, për kryerjen e transplantit të veshkës pranë qendrës spitalore universitare “Ibni Sina Hastanesi Sihhiye”, Ankara, Turqi.

5. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ministria e Shëndetësisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.78, datë 7.2.2007

**PËR MASËN, KRITERET DHE PROCEDURAT E PËRFITIMIT TË NJË PAKETE TË
VEÇANTË HIGJIENO-SANITARE, PËR INVALIDËT PARAPLEGJIKË DHE
TETRAPLEGJIKË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 9 të ligjit nr.8626, datë 22.6.2000 “Për statusin e invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik”, të ndryshuar, dhe të nenit 12 të ligjit nr.9645, datë 27.11.2006 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2007”, me propozimin e Ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta dhe të Ministrit të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Invalidët paraplegjikë dhe tetraplegjikë, të cilët e kanë përfituar këtë status me vendim të komisionit mjekësor të përcaktimit të aftësisë për punë (KMCAP) dhe që vlerësohen se kanë humbje

të plotë të sensibilitetit dhe të motorikës nga niveli i dëmtimit, poshtë, në të dyja anësitë, përfitojnë një pagesë shtesë, në masën 9 000 (nëntë mijë) lekë në muaj, për mbulimin e paketës së domosdoshme me materiale të veçanta higjieno-sanitare.

2. Pagesa shtesë, që përfitohet sipas pikës 1 të këtij vendimi, tërhiqet në zyrën e njësisë së qeverisjes vendore, ku paraplegjikët dhe tetraplegjikët përfitojnë pagesën e aftësisë së kufizuar.

3. Për të përfituar këtë pagesë invalidët paraplegjikë dhe tetraplegjikë duhet të dalin në KMCAP, pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

4. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i vitit 2007, zëri “Transferta të familjeve dhe të individëve”, grupi 25, titulli 064, kapitulli 1, artikulli 606, miratuar për Ministrinë e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta.

5. Ngarkohen Ministria e Financave, Ministria e Shëndetësisë dhe Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.83, datë 17.2.2007

**PËR KRITERET E NDËRTIMIT ME KONCESION, TË FORMËS ROT/BOT, TË
TERMOCENTRALIT NË FIER**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3 të ligjit nr.9663, datë 18.12.2006 “Për koncesionet”, me propozimin e Ministrisë të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ndërtimi me koncesion, të formës ROT/BOT, të impiantit të prodhimit të energjisë elektrike në Fier.

2. Kriteret për dhënien me koncesion, përveç atyre të parashikuara në ligjin “Për koncesionet”, do të jenë edhe ato të përcaktuara në shtojcën 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

3. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

SHTOJCA NR.1

**KRITERET E VLERËSIMIT TË OFERTAVE PËR DHËNIEN ME KONCESION TË FORMËS
ROT/BOT TË TEC-IT FIER**

	Përqindja e vlerësimit
a) Kapaciteti i instaluar (në MW)	5
b) Disponibiliteti i impiantit (në përqindje)	10
c) Sasia vjetore e prodhimit (në MWh)	10
d) Çmimi i energjisë së ofruar për shitje (EURO/MWh) në kontratën e shitblerjes	40

e) Koha e fillimit të prodhimit të energjisë elektrike	20
f) Koha e zgjatjes së periudhës koncesionare	8
g) Pagesa e së drejtës koncesionare	7
(Oferta fillon me çmimin fillestar 1 euro.)	

- Afati maksimal për kontratën e shitblerjes së energjisë do të jetë 10 vjet.
- Autoriteti kontraktues do të përcaktojë sasinë dhe fuqinë maksimale vjetore të energjisë për blerje në kontratën e shitblerjes.

VENDIM
Nr.84, datë 17.2.2007

**PËR OBJEKTET E KORPORATËS ELEKTROENERGJETIKE SHQIPTARE (KESH) SHA,
QË NUK DO TË KONSIDEROHEN PJESË TË SEKTORËVE ME RËNDËSI TË VEÇANTË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 4 të ligjit nr.8306, datë 14.3.1998 “Për strategjinë e privatizimit të sektorëve me rëndësi të veçantë”, të neneve 4, pika 3, dhe 5, pika 3, të ligjit nr.9663, datë 18.12.2006 “Për koncesionet”, dhe të nenit 22 të ligjit nr.7512, datë 10.8.1999 “Për sanksionimin dhe mbrojtjen e pronës private, të nismës së lirë, të veprimtarive private të pavarura dhe privatizimit”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Nuk do të konsiderohen pjesë të sektorëve me rëndësi të veçantë objektet e mëposhtme të KESH sh.a.:

- Termocentrali Tiranë,
- Termocentrali Cërrik,
- Termocentrali Vlorë,
- Termocentrali Kuçovë,
- Termocentrali Korçë,
- Termocentrali Maliq,
- Termocentrali Fier.

2. Objektet e përcaktuara në pikën 1 të këtij vendimi, të cilat vlerësohen se paraqesin interes për investime private, në fushën e prodhimit të energjisë elektrike, të jepen me koncesion, duke filluar me çmimin simbolik 1 euro. Pjesa tjetër e objekteve do t'i nënshtrohet procedurave të privatizimit, sipas akteve, ligjore dhe nënligjore, në fuqi.

3. Autoriteti kontraktues për dhënien me koncesion të këtyre objekteve është Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës.

4. Shpenzimet për realizimin e procedurave për dhënien me koncesion, të përballohen nga KESH sh.a.

5. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.85, datë 17.2.2007

**PËR MIRATIMIN E PROCEDURAVE TË NOTIFIKIMIT TË KUADRIT LIGJOR
TREGTAR, EKONOMIK DHE FINANCIAR, NË ORGANIZATËN BOTËRORE TË
TREGTISË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e procedurave të notifikimit të kuadrit ligjor tregtar, ekonomik dhe financiar në Organizatën Botërore të Tregtisë.

I. PËRKUFIZIME:

Për qëllime të zbatimit të këtij vendimi, me termat e mëposhtëm nënkuptohen:

1. “Notifikim” - detyrimi i Organizatës Botërore të Tregtisë (më poshtë OBT) për të raportuar, informuar dhe depozituar në organet përgjegjëse, për të gjitha masat me efekt në tregtinë e mallrave, shërbimeve, në pronësinë intelektuale dhe prokurimin publik, të marra nga vendet anëtare të OBT-së.

2. “Pikë referimi”- institucionet përgjegjëse për dhënien e informacionit të nevojshëm për kuadrin ligjor në fuqi në Republikën e Shqipërisë për tregtinë e mallrave, të shërbimeve, për pronësinë intelektuale dhe prokurimin publik, si në përgjigje të kërkesave të vendeve anëtare të OBT-së.

3. “Masa kundërbalancuese” - tarifat doganore shtesë, të cilat zbatohen me hyrjen e mallit në territorin e Republikës së Shqipërisë, përveç tarifave doganore të kombit më të favorizuar, për të balancuar subvencionin e dhënë gjatë prodhimit, fabrikimit ose eksportimit të një produkti, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose tërthorazi.

4. “Masa mbrojtëse” - tarifat doganore shtesë që zbatohen, përveç tarifave doganore të kombit më të favorizuar, në rastin kur vëllimi i mallrave të importuara është më i lartë se vëllimi normal i importit, i cili vlerësohet dhe përcaktohet në bazë të të dhënave statistikore në tri vitet e fundit, dhe që shkakton ose kërcënon të shkaktojë dëme në industrinë vendase.

5. “Taksa doganore të ndryshueshme”- taksat doganore, të cilat ndryshojnë në përputhje me kriteret e brendshme, duke synuar që çmimi i produktit në tregun e brendshëm të mbetet i pandryshuar, pavarësisht luhatjes së çmimeve në tregjet botërore.

6. “Kutia jeshile” — subvencionet e brendshme, që zbatohen në bujqësi, të cilat nuk kanë efekt ose kanë efekt minimal shtrembërues në tregti ose efekt në prodhim dhe janë të përjashtuara nga detyrimi për reduktim.

II. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Ky vendim ka për qëllim përcaktimin dhe miratimin e procedurave të notifikimit në OBT të të gjitha akteve ligjore, të dala pas anëtarësimit të Republikës së Shqipërisë në këtë organizatë më 8 shtator 2000, si dhe të çdo ndryshimi të tyre, të vendimeve të Këshillit të Ministrave, rregulloreve dhe udhëzimeve, si dhe të çdo mase tjetër, me efekt në tregtinë e mallrave, të shërbimeve, në pronësinë intelektuale, prokurimin publik dhe aviacionin civil, pavarësisht nga përputhshmëria ose jo me marrëveshjet e OBT-së, si dhe të ndryshimeve të angazhimeve specifike që Republika e Shqipërisë ka marrë në kuadër të anëtarësimit në këtë organizatë.

2. Ministritë, institucionet e tjera, qendrore dhe të varësisë, janë të detyruara të zbatojnë detyrimet dhe procedurat specifike të notifikimit për fushat e veçanta që mbulojnë, dhe të përfshira në marrëveshjen e Marrakeshit, që themeloi OBT-në, të parashtruara në pjesët III, IV, V, VI e VII të këtij vendimi, përfshirë edhe ndryshime apo shtesa të detyrimeve procedurave, që do të jenë rezultat i raundeve të negociatave shumëpalëshe, që zhvillohen nga vendet anëtare të OBT-së.

3. Ngarkohen ministritë dhe institucionet e tjera qendrore, në varësi të Këshillit të

Ministrave, të fillojnë kryerjen e notifikimeve, sipas fushave në varësi të tyre, në përputhje me detyrimet e përshkuara në pjesët III, IV, V, VI e VII të këtij vendimi, duke plotësuar formatet standarde të notifikimit, dhe t'i depozitojnë ato në Ministrinë e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, në përputhje me afatet e përcaktuara.

4. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës të bashkërendojë punën dhe të monitorojë përmbushjen e detyrimeve dhe të procedurave të notifikimit në OBT, si dhe të mbajë lidhjet me misionin e Republikës së Shqipërisë pranë Kombeve të Bashkuara dhe me organizatat e tjera ndërkombëtare me seli në Gjenevë.

5. Ngarkohet misioni i Republikës së Shqipërisë pranë Kombeve të Bashkuara dhe organizatat e tjera ndërkombëtare me seli në Gjenevë të kryejë depozitim të notifikimeve në organet përkatëse të OBT-së dhe në qendrën e regjistrimit të notifikimeve të kësaj organizate.

6. Kuadri ligjor, që lidhet me tregtinë, duhet të notifikohet në një rreth nga gjuhët zyrtare të OBT-së, në anglisht, frëngjisht ose spanjisht, në formë elektronike dhe formë të shkruar. Ngarkohen ministritë dhe institucionet e tjera qendrore të paraqesin pranë Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës (Drejtoria e Politikave Tregtare, sektori për marrëdhëniet me OBT-në dhe integrimin ekonomik) të gjithë dokumentacionin që do të notifikohet në OBT.

7. Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës (Drejtoria e Politikave Tregtare, sektori për marrëdhëniet me OBT-në dhe integrimin ekonomik) të jetë pika e referimit të kuadrit ligjor për tregtinë e mallrave e të shërbimeve dhe pronësinë intelektuale.

8. Ngarkohen të gjitha ministritë dhe institucionet qendrore, të cilat janë të detyruara të kryejnë notifikimet sipas këtij vendimi, të caktojnë një pikë kontakti dhe të njoftojnë Ministrinë e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës brenda 30 ditëve pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi. Kjo pikë kontakti do të jetë përgjegjëse për bashkërendimin e punës në përmbushje të detyrimeve të notifikimeve, sipas fushave që mbulon institucioni.

9. Me vendim të Këshillit të Ministrave bëhen:

a) notifikimi i kuadrit ligjor për rregullat teknike, standardet, procedurat për vlerësimin e konformitetit, të cilat lidhen me zbatimin e marrëveshjes për barrierat teknike në tregti, në përputhje me rregullat, procedurat e përcaktuara dhe marrëveshjet e OBT-së.

b) notifikimi i kuadrit ligjor për standardet, masat sanitare dhe fitosanitare, në përputhje me marrëveshjet e OBT-së.

III. DETYRIMET PËR NOTIFIKIMIN E MASAVE, ME EFEKT NË TREGTINË E MALLRAVE

1. Në zbatim të neneve II “Skeduli i koncesioneve”, III “Trajtimi kombëtar dhe rregulloret për taksimin e brendshëm”, X “Publikimi dhe administrimi i rregullave tregtare”, XI “Eliminimi i përgjithshëm i kufizimeve sasiore”, XVI “Subvencionet”, XVIII “Asistenca e qeverisë për zhvillimin ekonomik”, XXIV “Aplikimet territoriale, zonat e tregtisë së lirë dhe bashkimet doganore”, XXVIII “Modifikimi i skeduleve të koncesioneve tarifore” të marrëveshjes të përgjithshme “Për tarifatat dhe tregtinë”, GATT, 1994, institucionet e mëposhtme, duhet të notifikojnë:

i) tarifatat doganore detyruese ndaj OBT-së dhe tarifatat doganore të kombit më të favorizuar të çdo viti fiskal. Notifikimi bëhet brenda datës 31 mars të çdo viti. Institucioni përgjegjës është Drejtoria e Përgjithshme e Doganave.

ii) të dhënat e hollësishme të importit, të ndara me shtete dhe me kode tarifore. Afati maksimal i notifikimit është data 30 shtator e çdo viti pasardhës. Institucioni përgjegjës është Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës.

iii) tarifatat preferenciale, në kuadër të sistemit të përgjithshëm të preferencave. Notifikimi i tyre të kryhet përpara hyrjes në fuqi të sistemit të tarifave preferenciale. Institucioni përgjegjës është Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës.

iv) kuotat tarifore, mbitaksat dhe detyrime të tjera, të ndryshme nga tarifatat doganore të kombit më të favorizuar. Notifikimi të kryhet menjëherë, me marrjen e masave të tilla. Institucioni përgjegjës është Drejtoria e Përgjithshme e Doganave.

v) të gjitha ligjet dhe rregulloret, që lidhen me taksat që zbatohen brenda vendit. Notifikimi

të kryhet menjëherë, me miratimin e ligjeve dhe të rregulloreve. Institucioni përgjegjës është Ministria e Financave.

vi) taksat e eksporteve dhe taksat doganore të ndryshueshme. Notifikimi të kryhet menjëherë, me marrjen e masave të tilla. Institucioni përgjegjës është Drejtoria e Përgjithshme e Doganave.

vii) subvencionet në eksporte, përjashtimet nga taksat dhe financimet koncesionare për eksportet. Notifikimi të kryhet menjëherë, me marrjen e masave të tilla. Institucioni përgjegjës është Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës.

viii) zonat e lira, përfshirë edhe prodhimin që rezulton nga përdorimi i lëndëve të para, të përjashtuara nga tarifatat doganore, kur prodhimi është i destinuar për eksport. Notifikimi të kryhet menjëherë, me miratimin e kuadrit ligjor për zonat e lira. Institucioni përgjegjës është Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës.

ix) kontrollet për kursin e këmbimit, që lidhen me importet dhe eksportet. Notifikimi bëhet menjëherë, me marrjen e masave të tilla. Institucioni përgjegjës është Ministria e Financave.

x) shkëmbimet tregtare mall me mall, të miratuara nga organet shtetërore. Notifikimi të kryhet menjëherë, me marrjen e masave të tilla. Institucioni përgjegjës është Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës.

xi) marrëveshjet e tregtisë së lirë ose marrëveshjet për krijimin e bashkimeve doganore, si dhe përgjigjet për pyetje standarde, të miratuara nga vendet anëtare. Notifikimi të kryhet menjëherë, me nënshkrimin e tyre, por para hyrjes në fuqi. Institucioni përgjegjës është Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës.

xii) ndryshimet e angazhimeve tarifore, të përfshira në skedulën e koncesioneve tarifore, pjesë e protokollit të anëtarësimit të Republikës së Shqipërisë në OBT. Notifikimi të kryhet të paktën 3 muaj përpara zbatimit. Institucioni përgjegjës është Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës.

2. Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, në zbatim të paragrafëve të dytë dhe të tretë të nenit 18 “Rishikimi i zbatimit të angazhimeve” të marrëveshjes së bujqësisë duhet të notifikojë:

- i) të gjitha llojet e subvencioneve, që mbulohen nga kategoria e “Kutia jeshile”, të tilla si:
 - a) shërbime të përgjithshme;
 - b) krijimi i rezervave, për qëllime të sigurisë ushqimore;
 - c) ndihma ushqimore e brendshme;
 - ç) pagesat e drejtpërdrejta për prodhuesit;
 - d) mbështetje për të ardhurat e përgjysmuara;
 - dh) pjesëmarrja financiare e shtetit në programet e sigurimit të të ardhurave dhe në programet e sigurisë neto të të ardhurave;
 - e) pagesat (të kryera qoftë drejtpërdrejt, qoftë përmes një pjesëmarrjeje financiare të qeverisë në programet e sigurimit të prodhimeve) për ndihmë në raste të katastrofave natyrore;
 - e) ndihma për rregullime strukturore, të dhëna nëpërmjet programeve, që lidhen me daljen në pension;
 - f) ndihma për rregullime strukturore, të dhëna nëpërmjet programeve të daljes në pension, që lidhen me heqjen e burimeve të prodhimit;
 - g) ndihma për axhustime strukturore, të dhëna përmes ndihmës për investime;
 - gj) pagesa, në kuadër të programeve mjedisore;
 - h) pagesa në kuadër të programeve të ndihmës rajonale;
 - i) subvencione të tjera.
- ii) subvencionet e brendshme, të cilat jepen në përputhje me paragrafin e pestë të nenit 6 të marrëveshjes për bujqësinë “Angazhimet për subvencionet e brendshme”, pagesat e drejtpërdrejta, në kuadër të programeve të kufizimit të prodhimit, të tilla si:
 - a) pagesa, që bazohen te sipërfaqet fikse ose te rendimenti;
 - b) pagesa, në nivelin 85 për qind ose më pak të nivelit bazë të prodhimit;
 - c) pagesa për gjënë e gjallë, që bëhet në bazë të një numri fiks krerësh.
- iii) subvencionet për produkte specifike, të cilat nuk e kalojnë nivelin minimal prej 5% të

prodhimit bujqësor për këto produkte; ose

subvencione në total për të gjithë bujqësinë, që nuk e kalojnë nivelin minimal prej 5 % të totalit të prodhimit të përgjithshëm bujqësor, kur subvencioni jepet, në përgjithësi, për të gjitha degët e bujqësisë.

iv) subvencionet, që jepen për eksportimin e produkteve bujqësore, si dhe subvencione të tjera të palejueshme, të cilat u nënshtrohen procedurave të kompensimeve tregtare.

Për të gjitha llojet e subvencioneve, notifikimi duhet të kryhet brenda 90 ditëve të para të vitit, për të cilin është dhënë subvencioni.

3. Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, në zbatim të nenit 5 “Notifikimi dhe marrëveshjet transitorë” të marrëveshjes “Për masat, që lidhen me investimet-TRIMS”, të notifikojë, brenda 90 ditëve nga hyrja në fuqi e marrëveshjes, të gjitha masat, të shprehura në ligje, vendime apo akte administrative, që lidhen me:

i) blerjen ose përdorimin nga një shoqëri ose nga ndonjë burim i brendshëm, të produkteve me origjinë shqiptare, të ofruara qoftë edhe si një produkt i veçantë, në formën e vëllimit apo vleftës së tyre ose në formën e raportit të vëllimit a të vleftës së prodhimit vendas;

ii) përdorimin ose blerjen nga shoqëritë të produkteve të importit, të kufizuara në vlerë ose vëllim, në përqindje ose shifër, të prodhimit vendas të eksportuar;

iii) kufizimet në importimin e produkteve të përdorura apo të lidhura me prodhimin vendas, në përgjithësi ose në një masë, që lidhet me vëllimin ose vlerën e prodhimit të brendshëm, që eksportohet;

iv) importimin, nga një ndërmarrje, të produkteve që përdoren ose janë të lidhura me prodhimin vendas, duke kufizuar shkëmbimin valutor, në një sasi, në varësi të valutës së futur nga kjo ndërmarrje;

v) eksportimin ose shitjen për eksport të produkteve të një ndërmarrjeje, pavarësisht nëse shprehet në formën e produktit të veçantë, në formën e vëllimit apo vleftës së produkteve, apo në raport me vëllimin apo vleftën e prodhimit të saj të brendshëm.

4. Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës në zbatim të nenit 6 “Transparenca” të marrëveshjes “Për masat që lidhen me investimet—TRIMS”, të zbatojë detyrimin për notifikim dhe publikim të të gjithë kuadrit ligjor ekzistues, të ndryshimeve të tij, si dhe të kuadrit të ri të hartuar, që rrjedhin nga neni X i GATT-it, 1994. Raportimi bëhet sa herë që një akt ligjor/nënligjor, që lidhet me investimet, miratohet nga Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë.

5. Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, në zbatim të paragrafëve të katërt e të pestë të nenit 16 “Komiteti për praktikant antidumping” dhe të nenit 18.5 “Dispozita përfundimtare” të marrëveshjes për zbatimin e nenit VI të marrëveshjes së përgjithshme “Për tarifatat dhe tregtinë, GATT, 1994” (Marrëveshja për masat antidumping), të notifikojë:

i) masat antidumping, të vendosura në Republikën e Shqipërisë për produkte të caktuara. Raportimi të jetë periodik, 6-mujor. Për 6-mujorin e parë, raportimi bëhet brenda datës 30 qershor kurse për 6-mujorin e dytë bëhet brenda datës 31 dhjetor të çdo viti.

ii) kuadrin ligjor ekzistues dhe ndryshimet e tij, si dhe kuadrin e ri ligjor. Notifikimi të kryhet menjëherë, pas miratimit të kuadrit ligjor.

iii) autoritetin përgjegjës, që ndërmerr dhe ndjek hetimet për praktikant antidumping. Notifikimi të kryhet menjëherë, me ngritjen e këtij autoriteti.

6. Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, në zbatim të nenit 22 “Legjislacioni kombëtar” të marrëveshjes për zbatimin e nenit VII të marrëveshjes së përgjithshme “Për tarifatat dhe tregtinë, GATT, 1994” (Marrëveshja për vlerësimin doganor), si dhe të vendimeve, që lidhen me interpretimin e marrëveshjes për vlerësimin doganor, të notifikojë:

i) të gjitha ligjet, rregulloret dhe vendimet administrative ekzistuese, që lidhen me zbatimin e marrëveshjes së mësipërme, kuadrin ligjor në fuqi, menjëherë, me miratimin e tyre.

ii) datën e zbatimit, në legjislacionin e brendshëm, të vendimit të OBT-së “Për trajtimin e pagesave të interesave, në vlerësimin doganor të mallrave të importuara”, nëse pranohet vendimi.

iii) datën e zbatimit, në legjislacionin e brendshëm, të vendimit të OBT-së “Për përcaktimin e vlerës së mjeteve transmetuese, bartëse të programeve kompjuterike për pajisje përpunuese të

dhënash”, nëse pranohet vendimi.

iv) pyetësonin e miratuar nga OBT-ja, për çështje të vlerësimit doganor.

7. Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, në zbatim të nenit 5 “Notifikimi” të marrëveshjes së inspektimit para ngarkimit, të notifikojë tekstin e ligjeve dhe të rregulloreve, për shërbimin e inspektimit para ngarkimit, menjëherë pas botimit të tyre.

8. Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, në zbatim të nenit 5 “Informimi dhe procedurat për modifikimin, prezantimin e rregullave të reja të origjinës” dhe të aneksit II “Deklarata e përbashkët për rregullat preferenciale të origjinës” të marrëveshjes për rregullat e origjinës, të notifikojë:

i) rregullat ekzistuese të origjinës, akteve nënligjore të Këshillit të Ministrave dhe rregullat administrative me zbatim të përgjithshëm dhe që lidhen me rregullat e origjinës, që janë në fuqi në datën e hyrjes në fuqi të marrëveshjes. Notifikimi të kryhet brenda 90 ditëve pas hyrjes në fuqi të marrëveshjeve të OBT-së;

ii) aktet e reja ligjore, që ndryshojnë rregullat ekzistuese të origjinës apo përcaktojnë rregulla të reja origjine. Notifikimi të kryhet 60 ditë përpara hyrjes në fuqi të tyre.

iii) rregullat preferenciale të origjinës, përfshi këtu edhe marrëveshjet preferenciale për këto rregulla, vendimet e Këshillit të Ministrave dhe rregullat administrative me zbatim të përgjithshëm, që lidhen me rregullat preferenciale të origjinës, si dhe çdo ndryshim i mëtejshëm të tyre. Notifikimi të kryhet menjëherë, me miratimin e rregullave preferenciale.

9. Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, Ministria e Mbrojtjes, Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, në zbatim të neneve 1 “Dispozita të përgjithshme”, 4 “Notifikimi”, 7 “Rishikimi” dhe 8 “Dispozita përfundimtare” të marrëveshjes për licencimet e importeve, të notifikojnë:

i) burimin, ku është botuar informacioni për procedurat e dhënies së licencave të importit. Notifikimi të kryhet menjëherë, me marrjen e një mase të tillë.

ii) ndryshimet, që u bëhen procedurave ekzistuese të licencimit të importeve. Notifikimi të kryhet brenda 60 ditëve nga miratimi i tyre.

iii) plotësimin e pyetësonit për procedurat e licencimit të importeve dhe procedurat e ngjashme administrative. Notifikimi kryhet brenda datës 30 shtator të çdo viti.

iv) kuadrin ligjor dhe të gjitha vendimet administrative, që lidhen me dhënien e licencave të importit, si dhe çdo ndryshim të këtij kuadri ligjor. Notifikimi të kryhet me hyrjen në fuqi të marrëveshjes së licencimit të importeve, si dhe në çastin e miratimit të ndryshimeve.

10. Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, në zbatim të nenit XVI “Subvencionet”, të GATT-it, 1994, të neneve 25 “Notifikimet” dhe 36 “Dispozita të tjera përfundimtare” të marrëveshjes për subvencionet dhe masat kundërbalancuese, të notifikojë:

i) të gjitha llojet e subvencioneve, qofshin këto subvencione për produkte ose industri specifike apo subvencione të drejtpërdrejta ose jo. Notifikimi të kryhet menjëherë, me marrjen e këtyre masave.

ii) autoritetin kombëtar përgjegjës, që ndërmerr dhe drejton procedurat e hetimit për masat kundërbalancuese, si dhe procedurat e brendshme, që rregullojnë nisjen dhe ndjekjen e hetimit. Notifikimi të kryhet menjëherë, me krijimin e këtij autoriteti.

iii) të gjithë kuadrin e plotë ligjor rregullator apo vendimet dhe procedurat administrative, që lidhen me subvencionet dhe masat kundërbalancuese ekzistuese, dhe çdo ndryshim të mëvonshëm të këtij kuadri ligjor apo të ri. Notifikimi të kryhet me hyrjen në fuqi të marrëveshjes së OBT-së, si dhe menjëherë me kryerjen e çdo ndryshimi.

iv) vendosjen e masave, paraprake dhe përfundimtare, kundërbalancuese, si dhe raportimin, në periudha 6-mujore, për vendosjen ose jo të masave kundërbalancuese për periudhën 6-mujore pararendëse. Notifikimi të bëhet menjëherë, me vendosjen e masave, si dhe brenda muajve janar dhe korrik të çdo viti, për raportimin për periudhat 6-mujore.

11. Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, në zbatim të nenit XIX të GATT-it, 1994 dhe të neneve 11 “Ndalimi dhe eliminimi i disa masave” e 12 “Notifikimi dhe konsultimi” të marrëveshjes për masat mbrojtëse, të notifikojë:

i) të gjitha ligjet, rregullat dhe procedurat administrative ekzistuese, si dhe ndryshimet e kuadrin ligjor në fuqi apo të akteve të dala në zbatim të tij. Notifikimi të kryhet menjëherë, me

miratimin e tyre.

ii) autoritetin kombëtar përgjegjës, që ndërmerr dhe drejton procedurat e hetimit për masat mbrojtëse, si dhe procedurat e brendshme, që rregullojnë nisjen dhe ndjekjen e hetimit. Notifikimi të kryhet menjëherë, me krijimin e këtij autoriteti.

iii) fillimin e një procesi hetimi për dëme serioze ose kërcënime për shkaktimin e dëmeve serioze në industrinë vendase. Notifikimi të kryhet menjëherë, me fillimin e procesit të hetimit.

iv) vendosjen e masave, të tilla si: kufizime sasiore, përfshi këtu kufizimet vullnetare të eksporteve, si dhe marrëveshjet e zakonshme të marketingut, që ndikojnë tek importet, zvogëlimi i flukseve të eksportit, sistemet e monitorimit të çmimeve të eksportit dhe të importit, mbikëqyrja e eksporteve dhe e importeve, mbajtja e detyrueshme e karteleve për importet, skemat diskrecionare të licencimit të importeve dhe eksporteve, të cilat shërbejnë si masa mbrojtëse ndaj importeve.

12. Banka e Shqipërisë dhe Ministria e Financave, në zbatim të neneve XII “Kufizime për të mbrojtur bilancin e pagesave” dhe XVIII “Asistenca e qeverisë për zhvillimin ekonomik”, të marrëveshjes së GATT-it, 1994, dhe të dokumentit “Mirëkuptim për dispozitat për bilancin e pagesave, të marrëveshjes së GATT-it, 1994”, të notifikojnë masat kufizuese për importin e mallrave në rastet e vështirësive serioze në bilancin e pagesave, të tilla si: ulja e menjëhershme e rezervave monetare ose në rastin kur ka rezerva të pakta monetare. Notifikimi të kryhet jo më vonë së 30 ditë përpara zbatimit të masave të marra.

13. Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, në bazë të nenit XVII “Ndërmarrjet tregtare shtetërore” të marrëveshjes së GATT-it, 1994, si dhe të dokumentit “Mirëkuptim për interpretimin e nenit XVII të marrëveshjes së GATT-it, 1994”, të notifikojë, të paktën një herë në dy vjet, ndërmarrjet, shtetërore ose joshtetërore, tregtare, të cilave u janë dhënë privilegje ose të drejta të veçanta apo ekskluzive, si edhe ato të dhëna me Kushtetutë apo ligj, të cilat gjatë ushtrimit të veprimtarisë tregtare ndikojnë, nëpërmjet shitjes ose blerjes, në nivelin ose drejtimin e importeve apo të eksporteve. Gjithashtu, në bazë të paragrafit të tridhjetë të raportit të anëtarësimit të Republikës së Shqipërisë në OBT, Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës duhet të depozitojë në OBT raporte vjetore për ecurinë e procesit të privatizimit të ndërmarrjeve shtetërore, deri në përfundimin e tij.

IV. DETYRIMET PËR NOTIFIKIM TË MASAVE, ME EFEKT NË TREGTINË E SHËRBIMEVE

1. Institucionet përgjegjëse për tregtinë e shërbimeve, në zbatim të neneve III “Transparenca”, V “Integrimi ekonomik”, V bis. “Marrëveshjet për integrimin e tregjeve të punës”, VII “Njohja”, VIII “Ofruesit, monopol dhe ekskluziv, të shërbimeve”, XI “Pagesat dhe transfertat”, XII “Kufizime për të mbrojtur bilancin e pagesave”, XV “Subvencionet”, XVI “Hyrja në treg”, XVII “Trajtimi kombëtar”, XXI “Modifikimi i skeduleve”, të marrëveshjes së përgjithshme për tregtinë në shërbime (GATS) të OBT-së, si dhe të skedulit të angazhimeve të veçanta në shërbime, të notifikojnë, sipas formatit përkatës:

i) ligjet, rregulloret dhe udhëzuesit administrativ të rinj apo ndryshimet e atyre ekzistuese në fushat, ku Shqipëria ka marrë angazhime të veçanta, të përfshira në skedulën e këtyre angazhimeve, pjesë e protokollit të anëtarësimit në OBT. Notifikimi të kryhet menjëherë, me miratimin e ligjit, ose të paktën një herë në vit.

ii) marrëveshjet, dypalëshe ose rajonale, të integritit ekonomik. Notifikimi të kryhet menjëherë, me nënshkrimin e marrëveshjes apo të ndryshimeve të marrëveshjes ekzistuese.

iii) marrëveshjet, dypalëshe ose rajonale, që formojnë integrim të plotë të tregjeve të punës. Notifikimi të kryhet, menjëherë, me miratimin e marrëveshjes.

iv) masat për njohjen e njëanshme ose marrëveshjet për njohjen e ndërsjellë të diplomave apo të kualifikimeve a të kushteve për dhënien e licencave për ushtrimin e veprimtarive. Notifikimi të kryhet menjëherë, me nënshkrimin e marrëveshjes apo të ndryshimeve të marrëveshjeve ekzistuese.

v) operatorët e shërbimeve të çfarëdolloj fushe, që veprojnë në kushte monopol apo në kushtet e ofruesit ekskluziv të shërbimit. Notifikimi të kryhet të paktën 90 ditë përpara dhënies të së drejtës së monopolit ose të së drejtës ekskluzive.

vi) masat kufizuese, që pengojnë realizimin e pagesave dhe të transfertave ndërkombëtare. Notifikimi të kryhet jo më vonë se 90 ditë përpara zbatimit të masës.

vii) masat, që merren për mbrojtjen e bilancit të pagesave. Notifikimi të kryhet menjëherë, me adoptimin e tyre.

viii) subvencionet, që jepen për sektorë apo operatorë të ndryshëm shërbimesh. Notifikimi të kryhet jo më vonë se 90 ditë përpara zbatimit të masës.

ix) masat, që krijojnë kufizime për hyrjen në treg, të tilla si: kufizime në numrin e ofruesve të shërbimeve, në vlerën e përgjithshme të rezultatit të shoqërive, në numrin e operacioneve të shërbimeve, që mund të kryejë një shoqëri, në numrin e personave fizikë, të huaj, që mund të punësohen në një shoqëri, në pjesëmarrjen në kapital, në llojin e formës së shoqërisë, si degë, filial apo zyrë përfaqësie, si dhe kufizime, që lidhen me domosdoshmërinë e kryerjes së testimit të tregut për nevoja ekonomike. Notifikimi të kryhet të paktën 90 ditë përpara zbatimit të këtyre masave.

x) masat diskriminuese në trajtimin kombëtar. Notifikimi të kryhet të paktën 90 ditë përpara zbatimit të këtyre masave.

xi) masat, që lidhen me modifikimin apo tërheqjen e angazhimeve të marra në skedulin e angazhimeve të veçanta. Notifikimi të kryhet të paktën 90 ditë përpara zbatimit të këtyre masave.

2. Institucionet përgjegjëse, që duhet të përmbushin detyrimet, që rrjedhin nga pika 1 e pjesën IV të këtij vendimi janë, si më poshtë vijon:

i) Ministria e Financave, për shërbimet e kontabilitetit dhe të taksimit;

ii) Ministria e Drejtësisë, për shërbimet ligjore, të avokatisë dhe noterisë;

iii) Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit për shërbimet e ndërtimit, shërbimet profesionale të inxhinierisë, arkitekturës, urbanistikës, shërbimet mjedisore, që lidhen me pastrimin dhe kanalizimet e ujërave të zeza, transportit rrugor, detar, ajror, hekurudhor dhe shërbimet ndihmëse, që lidhen me to, shërbimet e mirëmbajtjes dhe të riparimit të pajisjeve të transportit, si dhe shërbimet postare. Për shërbimet e telekomunikacionit institucion përgjegjës është dhe Enti Rregullator i Telekomunikacionit;

iv) Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, për shërbimet turistike, kulturore, argëtuese, sportive dhe shërbimet audio-vizuale;

v) Ministria e Shëndetësisë, për shërbimet profesionale mjekësore, stomatologjike, shërbimet e ofruara nga infermierët, mamitë, psikoterapistët dhe personeli paramjekësor, për shërbimet spitalore dhe të shitjes me shumicë e pakicë të produkteve, mjekësore dhe farmaceutike;

vi) Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, për shërbimet veterinarë, shërbimet, që lidhen me bujqësinë, gjuetinë dhe pyjet, si dhe për legjislacionin, që lidhet me shitblerjen e tokës;

vii) Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, për shërbimet e biznesit, shërbimet minerare, të shpërndarjes së energjisë, të shitjes me shumicë, pakicë dhe franchising, si dhe masat për modifikimin apo tërheqjen e angazhimeve.

viii) Ministria e Arsimit dhe Shkencës, për shërbimet në fushën e arsimit, shërbimet kërkimore-shkencore dhe marrëveshjet për njohjen e kualifikimeve, të diplomave dhe kërkesave për licencim.

ix) Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, për lëvizjen e përkohshme të personelit të nevojshëm për menaxhimin dhe drejtimin e shoqërive të shërbimeve, si menaxherët e lartë dhe ekzekutivë, specialistët, etj., që janë të domosdoshëm për përmbushjen e veprimtarive të shërbimeve, si dhe për marrëveshjet, dypalëshe ose rajonale, të integritit në tregjet e punës;

x) Banka e Shqipërisë, për shërbimet, bankare dhe financiare, lëvizjen dhe kontrollin e flukseve të kapitalit, si dhe masat që lidhen me mbrojtjen e bilancit të pagesave;

xi) Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, për shërbimet e sigurimit, të risigurimit dhe për shërbimet e letrave me vlerë dhe fondet e pensioneve;

xii) Ministria e Financave dhe Instituti i Ekspertëve Kontabël, për profesionin e ekspertit kontabël (auditimit).

V. DETYRIMET PËR NOTIFIKIMIN E MASAVE TREGTARE, QË LIDHEN ME

MBROJTJEN E TË DREJTAVE TË PRONËSISË INTELEKTUALE

1. Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Drejtoria e Përgjithshme e Markave dhe Patentave, Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, Autoriteti i Konkurrencës dhe Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, në zbatim të neneve 1 “Natyra dhe fusha e zbatimit të detyrimeve”, 3 “Trajtimi kombëtar”, 4 “Trajtimi i kombit më të favorizuar”, 9 “Lidhja me Konventën e Bernës”, 63 “Transparenca” të marrëveshjes së TRIPS-it, të notifikojnë:

i) të gjitha ligjet, vendimet e Këshillit të Ministrave, rregulloret dhe vendimet administrative, dhe përditësimin e tyre, që lidhen me mbrojtjen e të drejtave të pronësisë intelektuale. Notifikimi të kryhet menjëherë, me miratimin e tyre.

ii) përkufizimin ligjor të rrethit të personave, që përfitojnë nga marrëveshja e TRIPS-it. Notifikimi të kryhet, menjëherë, me përcaktimin e këtij përkufizimi.

iii) dhënien e trajtimit kombëtar, sipas kërkesave të nenit 6 të konventës së Bernës ose të paragrafit 1 (b) të nenit 16 të konventës së Romës. Notifikimi të kryhet me dhënien e trajtimit të kombit më të favorizuar.

iv) të gjitha marrëveshjet ndërkombëtare, ku Shqipëria është palë, të cilat përcaktojnë disa tipe përjashtimesh nga parimi i kombit më të favorizuar. Notifikimi të kryhet menjëherë, me miratimin e këtyre marrëveshjeve.

2. Institucionet përgjegjëse, që duhet të përmbushin detyrimet, që rrjedhin nga pika 1 e pjesës V e këtij vendimi janë:

i) Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, për të drejtat e autorit dhe të drejta të tjera të lidhura me to;

ii) Drejtoria e Markave dhe Patentave, për detyrimet, që lidhen me pronësinë industriale;

iii) Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, për detyrimet, që lidhen me treguesit gjeografikë;

iv) Autoriteti i Konkurrencës, për kuadrin ligjor për konkurrencën, kur ndryshimet lidhen me çështje të mbrojtjes të së drejtave të pronësisë intelektuale nga konkurrenca e pandershme;

v) Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, për kodin doganor ose dispozitat zbatuese të tij, kur këto lidhen me mbrojtjen e të drejtave të pronësisë intelektuale nga mallrat pirate dhe të falsifikuara.

VI. DETYRIMET PËR NOTIFIKIMIN E MASAVE ME EFEKT NË FUSHËN E PROKURIMIT PUBLIK

1. Agjencia e Prokurimit Publik, në zbatim të nenit XIX “Informimi dhe rishikimi në lidhje me detyrimet e palëve” të marrëveshjes së prokurimit publik, të notifikojë të gjitha ligjet, rregulloret dhe procedurat administrative, që rregullojnë veprimtarinë në fushën e prokurimeve publike. Notifikimi të kryhet menjëherë, me miratimin e tyre.

2. Përveç kësaj, kjo agjenci duhet të përgatisë një raport vjetor, për statistikën e shoqërive, që kanë fituar kontrata publike, sipas vendeve, vlerës së kontratës, mallrave, shërbimeve apo punimeve të kryera etj., në bazë të një pyetësores, të hartuar dhe të miratuar nga vendet anëtare të OBT-së. Notifikimi i raportit të kryhet një herë në vit për të dhënat statistikore të vitit pararendës.

VII. DETYRIMET PËR NOTIFIKIMIN E MASAVE, QË MBULOHEN NGA MARRËVESHJA E OBT-SË PËR AVIACIONIN CIVIL

1. Drejtoria e Përgjithshme Aviacionit Civil, në zbatim të nenit 9.4 “Legjislacioni kombëtar i marrëveshjes për aviacionin civil”, të notifikojë të gjitha ligjet, rregulloret dhe aktet administrative ekzistuese, që lidhen me zbatimin e kësaj marrëveshjeje, si dhe çdo ndryshim dhe akt të ri ligjor.

Notifikimi duhet të bëhet menjëherë, me miratimin e tyre.

VIII. DISPOZITA TË FUNDIT

Ngarkohet Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

IX. HYRJA NË FUQI

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

UDHËZIM
Nr.3, datë 26.2.2007

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR.3, DATË 30.1.2006 TË
MINISTRIT TË FINANCAVE "PËR TATIMIN MBI VLERËN E SHTUAR"

Në mbështetje të nenit 102 pika 4 të Kushtetutës dhe në zbatim të ligjit nr.7928, datë 27.4.1995 "Për tatimin mbi vlerën e shtuar", i ndryshuar, Ministri i Financave

UDHËZON:

1. Në përmbajtjen e udhëzimit nr.3, datë 30.1.2006 të Ministrisë së Financave, në pikën 16.1 "Rimbursimi i eksportuesve", bëhen shtesat dhe ndryshimet si vijon:

- Në përmbajtjen e paragrafit të parë, nënparagrafët e dytë, të tretë dhe të katërt shfuqizohen.

- Në përmbajtjen e paragrafit të parë, mbas nënparagrafit të parë, shtohet një nënparagraf me përmbajtjen si vijon:

"Teprica kreditore, që kërkohet si e rimbursueshme, duhet të jetë më shumë se 400.000 lekë."

- Paragrafi i dytë shfuqizohet.

- Mbas paragrafit të pestë, shtohen dy paragrafë me këtë përmbajtje:

"Eksportuesve me risk zero, për shumat deri në 400.000 lekë, rimbursimi u bëhet në mënyrë automatike, me paraqitjen e kërkesës në degën e tatimeve.

Për kategoritë e tjera, rimbursimi i eksportuesve bëhet brenda 30 ditëve nga data e paraqitjes së kërkesës së tyre."

2. Ky udhëzim hyn në fuqi me botimin në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I FINANCAVE
Ridvan Bode

VENDIM
Nr.9, datë 21.2.2007

PËR MIRATIMIN E RREGULLAVE DHE PROCEDURAVE TË CERTIFIKIMIT TË
PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA BURIME TË RINOVUESHME

Në mbështetje të neneve 9 dhe 39, pika 1 dhe 2, të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 "Për sektorin e energjisë elektrike", i ndryshuar, Bordi i Komisionerëve, në mbledhjen e tij të datës 21.2.2007, pasi shqyrtoi draftin për rregullat dhe procedurat e certifikimit të prodhimit të energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme,

VENDOSI:

1. Miratimin e rregullave dhe procedurave të certifikimit të prodhimit të energjisë elektrike nga burime të rinovueshme.

2. Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Bujar Nepravishta

**RREGULLAT DHE PROCEDURAT E CERTIFIKIMIT TË PRODHIMIT TË ENERGIJISË
ELEKTRIKE NGA BURIMET E RINOVUESHME**

**PJESA E PARË
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

**Neni 1
Autoriteti**

Këto rregulla hartohen në bazë të nenit 39 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, Traktatit të Komunitetit të Energjisë, të ratifikuar me ligjin nr.9051, datë 3.4.2006, si dhe në përputhje me rregullat e praktikës dhe procedurave të ERE-s.

**Neni 2
Qëllimi**

Në funksion të zhvillimit dhe shfrytëzimit me efikasitet të burimeve energjetike të rinovueshme, qëllimi i këtyre rregullave është të sigurojnë një trajtim të barabartë e transparent për të gjithë prodhuesit e energjisë elektrike nga burime të rinovueshme, të cilët paraqesin në ERE kërkesën për marrjen e certifikatës së garancisë së origjinës dhe/ose certifikatës së gjelbër.

**Neni 3
Objekti**

Këto rregulla përcaktojnë kriteret dhe procedurat për marrjen e certifikatës së garancisë së origjinës (GO) dhe certifikatës së gjelbër (CGJ).

Këto rregulla parashikojnë udhëzime teknike dhe procedurale për lëshimin nga ERE të GO-së dhe CGJ-së për prodhuesit që gjenerojnë energji elektrike nga burime të rinovueshme.

**Neni 4
Zbatimi**

Këto rregulla do të zbatohen për certifikimin e prodhimit të energjisë elektrike nga prodhuesit që shfrytëzojnë burime energjie të rinovueshme, bazuar në procedurat e ERE-s.

**Neni 5
Përkufizime**

Fjalët dhe frazat e mëposhtme të përdorura në këtë rregullore do të kenë kuptimet e mëposhtme:

1. "Ligj" do të thotë ligji nr.9072, datë 22.5.2003 "Për sektorin e energjisë elektrike", me të gjitha ndryshimet.

2. "Bordi i Komisionerëve" do të thotë organi vendimmarrës i ERE-s, i përbërë nga pesë anëtarë të emëruar sipas procedurave të parashikuara nga ligji nr.9072, datë 22.5.2003 "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar

3. "ERE" do të thotë Enti Rregullator i Sektorit të Energjisë Elektrike.
4. "I licencuar" do të thotë një person që mban një licencë të dhënë sipas pjesës së tretë të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 "Për sektorin e energjisë elektrike".
5. Certifikimi do të thotë tërësia e veprimeve, që kryhen për zbatimin e legjislacionit në fuqi dhe në veçanti të këtyre rregullave deri në finalizimin e procesit me dhënien e certifikatës së garancisë së origjinës dhe/ose certifikatës së gjelbër. Certifikimi kryhet sipas dy hapave vijues: 1. kualifikimi i impianteve prodhuese të energjisë elektrike; 2. lëshimi i certifikatave GO dhe/ose CGJ.
6. Kualifikimi i impianteve prodhuese të energjisë elektrike, d.m.th. të gjithë veprimet e ndërmarra nga ERE, me kërkesën e prodhuesit, për të verifikuar që impianti prodhues ka karakteristikat e nevojshme për të kërkuar në vijim GO dhe/ose CGJ lidhur me energjinë elektrike të prodhuar.
7. Certifikata e garancisë së origjinës (GO) është dokumenti i lëshuar nga ERE, që vërteton se energjia elektrike (totale/ose e pjesshme) e prodhuar nga një prodhues paraprakisht i kualifikuar vjen me të vërtetë nga burime të rinovueshme.
8. Certifikata e gjelbër është dokumenti i lëshuar nga ERE, i cili vërteton që sasia e energjisë (e plotë/pjesshme) e prodhuar nga prodhuesi paraprakisht i kualifikuar, është energji e rinovueshme e mund të tregtohet si e tillë sipas kriterëve të përcaktuara në këtë rregullore. CGJ lëshohet nga ERE vetëm për energjinë e prodhuar nga një impiant prodhues i vënë në punë pas datës 2.11.2000.
9. Burime të energjisë së rinovueshme janë burimet e energjisë që prodhohen nga uji (hidro), era (eolike), dielli (solare), gjeotermale, lëvizje valore (dallgët), batica dhe zbatica, biomasa dhe biogazi.
10. Biomasa d.m.th. pjesa e biodegradueshme e produkteve, mjeteve dhe hedhurinave që vijnë nga bujqësia (përfshirë lëndët bimore, shtazore), pylltaria dhe industrinë e lidhura me to, si dhe pjesa e biodegradueshme e mbeturinave industriale dhe urbane.
11. Gjeotermale d.m.th. burimet gjeologjike natyrale të nxehtësisë së brendshme të tokës me origjinë reaksionet kimiko-fizike në shtresat përbërëse të saj.
12. Lëvizja valore d.m.th. lëvizja në formë kreshte ose valëzimi në sipërfaqen e oqeanëve, deteve dhe liqeneve e shkaktuar nga era dhe efektet gjeologjike dhe energjia e krijuar nga kjo lëvizje shfrytëzohet për prodhimin e energjisë elektrike.
13. Batica dhe zbatica d.m.th. ngritja dhe rënia e alternuar e sipërfaqes së oqeanëve, deteve, liqeneve, e cila ndodh dy herë në ditë dhe është rezultat i ndryshimit të forcave gravitacionale të ushtruara në pjesë të ndryshme të tokës nga një trup tjetër (dielli, hëna); energjia potenciale e kësaj lëvizje shfrytëzohet për prodhimin e energjisë.
14. Biogazi d.m.th. përzierja e gazit metan me dioksid karboni, e prodhuar nga dekompozimi bakterial i mbetjeve organike dhe që përdoret si lëndë djegëse për prodhimin e energjisë elektrike.
15. Subjekti relatues do të thotë Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të ERE-s e ngarkuar për shqyrtimin e një kërkesë për kualifikim dhe certifikim.
16. Kërkues do të thotë person fizik ose juridik, që kërkon të pajiset me certifikatën e garancisë së origjinës dhe/ose certifikatën e gjelbër.
17. Central prodhues i energjisë elektrike nga burime të rinovueshme është një impiant që prodhon energji nga burime të rinovueshme.
18. Prodhues hibrid është centrali elektrik, i cili konsumon të dyja llojet e burimeve të rinovueshme dhe jo të rinovueshme.
19. Korografia d.m.th. përshkrimi ose harta e një rajoni ose objekti, si dhe formimi fizik dhe përbërësit e këtij rajoni ose objekti.
20. Rezervë pompimi d.m.th. një sistem hidroelektrik, në të cilin energjia elektrike prodhohet gjatë periudhave të pikut të kërkesës nga përdorimi i ujit që është pompuar në një rezervuar në një lartësi më të madhe, gjatë periudhave jo të pikut, me kërkesë më të ulët për energji elektrike.

PJESA E DYTË
PROCEDURAT E CERTIFIKIMIT

Neni 6

Klasifikimi i centraleve të energjisë elektrike

Tipet e teknologjive prodhuese, të cilat mund të përfitojnë kualifikimin, janë përshkruar në tabelën 1.1.

Tabela 1.1. Klasifikimi i prodhuesve të energjisë të cilët gjenerojnë energji nga burime të rinovueshme

Tipi i impiantit	Nëntipi i impiantit	Burimi
Hidro	Rrjedhë lumi Rezervuar Basen Kanal derivacioni	Ujë
Era (eolike)	Të vendosur në det (onshore), në tokë (offshore)	Era
Gjeotermale	-	Energjia gjeotermale
Diellore (solare)	Fotovoltaike Fotovoltaike/termale	Energji diellore
Termale	Avulli Djegia brendshme Cikël i kombinuar Gazi Të tjera	Biomase***
		Biogaz
Hibrid* Bashkëdjegie** Të tjera	-	Burime konvencionale
	-	Burime të rinovueshme
Detare	-	Batica dhe zbatica
		Lëvizja valore (dallgët)

* Impiantet hibride gjenerojnë energji elektrike nga përdorimi i të dyja burimeve të rinovueshme dhe jo të rinovueshme dhe përfshijnë impiantet me bashkëdjegie.

** Bashkëdjegia përkufizohet si djegia njëkohësisht e lëndëve djegëse dhe trupave të ngurtë jo të rinovueshëm dhe lëndëve të lëngëta ose gazore të përfutuara nga burime të rinovueshme. Nëntipi i impiantit është i njëjtë me atë të impianteve termale.

*** Biomasa d.m.th. pjesa e biodegradueshme e produkteve, mbetjeve dhe hedhurinave që vijnë nga bujqësia (përfshirë lëndët bimore, shtazore), pylltaria dhe industrinë e lidhura me to, si dhe pjesa e biodegradueshme e mbeturinave industriale dhe urbane.

Neni 7

Kërkesat për kualifikimin e impianteve prodhuese

Prodhuesi, i cili dëshiron të marrë kualifikimin e impiantit prodhues, paraqet në ERE një kërkesë specifike me shkrim, duke përfshirë të gjithë informacionin e kërkuar nga legjislacioni në fuqi dhe ato të kërkuara nga kjo rregullore. Kualifikimi i një impianti prodhues kryhet vetëm një herë në të kundërt vetëm nëse janë kryer ndryshime të mëdha në impiante prodhuese të energjisë elektrike të kualifikuara më parë.

Kërkesa për kualifikim mund të paraqitet gjithashtu për një central prodhues energjie të rinovueshme dhe në fazën e projektimit ose në fazën e ndërtimit.

Kërkesa për kualifikim përfshin:

- një raport teknik specifik, që përshkruan tipin e teknologjisë gjeneruese, siç përcaktohet në tabelën e sipërpërmendur në nenin 6.

- një dokument teknik, i cili përshkruan karakteristikat bazë të prodhuesit të energjisë, përfshirë anekset teknike nëse ka.

- projekti i zbatimit të centralit në rastet e kualifikimit të kërkuar për një prodhues energjie ende në projekt ose në ndërtim (projekti i ndërtimit, elektromekanik, lidhjes me sistemin etj., i cili paraqitet për marrjen e lejes së ndërtimit).

- çdo dokument tjetër të lëshuar, që dëshmon kolaudimin dhe komisionimin e impiantit prodhues të energjisë.

Dokumenti teknik përmban:

1. përshkrimin e përgjithshëm të centralit:

a) burimet e energjisë (të rinovueshme ose jo);

b) tipin e centralit;

c) kapacitetin nominal që jepet nga shuma e kapacitetit nominal të turbinave ose agregatëve siç raportohet në targetat e secilit element;

d) prodhimin e pritshëm vjetor.

2. dokumentet vijuese grafike:

a) koreografia;

b) planimetria e përgjithshme;

c) skema funksionale;

d) skema elektrike, me qëllim identifikimin e matësve të gjenerimit të energjisë elektrike të certifikuar nga autoriteti publik kompetent.

3. përshkrimi i centralit duhet të jetë edhe më i detajuar për:

a) hidrocentralet që përdorin dhe rezerva pompimi, në mënyrë që të llogariten sasitë e energjisë së atribuar kësaj rezerve pompimi, mbasi kjo sasi energjie përjashtohet nga prodhimi që mund të përfitojë GO dhe/ose CGJ;

b) centrale hibride të energjisë elektrike, pasi vetëm energjia e prodhuar nga lëndë me prejardhje nga burime të rinovueshme mund të përfitojë GO dhe/ose CGJ;

c) centrale që djegin mbetje, me qëllim llogaritjen e pjesës së energjisë elektrike të prodhuar, që i atribuohet pjesës së biodegradueshme të mbetjeve, pasi vetëm kjo mund të përfitojë GO dhe/ose CGJ.

Neni 8

Fillimi i procedurave të kualifikimit të prodhuesve

ERE, në përputhje me rregullat e praktikës dhe procedurave të saj, merr vendim për fillimin e procedurave të shqyrtimit të kërkesës për kualifikim dhe cakton për çdo kërkesë subjektin relativ të çështjes, i cili është edhe pika e kontaktit të ERE me kërkuuesin. ERE mund të kërkojë çdo sqarim, si dhe të japë të gjithë informacionin e nevojshëm për palët në proces.

Neni 9

Shqyrtimi i aplikimit për kualifikim

1. Pas marrjes së vendimit për fillimin e procedurave të shqyrtimit sipas nenit 8 të kësaj rregulloreje, brenda 90 ditëve ERE shqyrton aplikimin dhe informon kërkuuesin për vendimin e Bordit mbi kualifikimin ose refuzimin e tij. Kualifikimi do të konsiderohet i kryer automatikisht nga ERE, në rast se asnjë komunikim nuk do t'i jepet kërkuuesit brenda 90 ditëve të sipërpërmendura.

2. Brenda periudhës së përcaktuar në paragrafin 1 të këtij neni, Bordi i Komisionerëve merr vendim për:

a) dhënien e kualifikimit të kërkuar, i cili regjistrohet në librin e kualifikimeve të ERE;

b) refuzimin në rast se subjekti nuk përmbush kërkesat e nevojshme për t'u kualifikuar;

c) pezullim.

3. Në çdo rast të vendimit për refuzim, ERE justifikon vendimin për refuzim. Kur ERE konstaton se kërkesa për kualifikim e paraqitur nga aplikuesi nuk përmban dokumente të rëndësishme që pengojnë ERE-n në verifikimin e përmbushjes së kritereve të kësaj rregulloreje, ERE specifikon që dokumenti është jo i plotë.

4. ERE merr vendim për pezullim kur kërkesa nuk përmban disa dokumente të cilat pengojnë ERE-n për verifikimin e përmbushjes së kritereve të kësaj rregulloreje. ERE i komunikon, kërkesit brenda 60 ditëve nga marrja e kërkesës, që shqyrtimi i kërkesës është pezulluar. ERE specifikon dokumentet që mungojnë ose janë jo të plota, të cilat duhet t'i paraqiten ERE-s brenda 60 ditëve në vijim. Në vijim të analizës së dokumentacionit shtesë kërkesa mund të pranohet ose refuzohet. Nëse dokumentacioni i munguar apo shtesë nuk dërgohet brenda 60 ditëve nga data e njoftimit nga ERE, kërkesa refuzohet për shkak të mosplotësimit të dokumentacionit të nevojshëm. Në këtë rast kërkuesi mund të paraqesë një kërkesë të re kualifikimi.

5. ERE, kur e sheh të nevojshme, mund t'u kërkojë çdo informacion organeve kompetente, duke informuar kërkuenin.

6. Në çdo rast të marrjes së vendimit nga Bordi për refuzimin e kualifikimit të kërkuar, aplikuesi mund të paraqesë një kërkesë të re duke marrë në konsideratë udhëzimet e ERE-s.

Neni 10

Lëshimi i garancive të origjinës (GO) dhe certifikatave të gjelbra (CGJ)

1. Prodhuesi mund të paraqesë kërkesë për marrjen e CGJ-së për sasinë e energjisë elektrike realisht të prodhuar, në bazë vjetore, nga centralet prodhuese të energjisë paraprakisht të kualifikuara, siç përshkruhet në nenin 7, 8 dhe 9 dhe pas vënies në punë të impiantit prodhues. Data e operimit të impiantit prodhues për herë të parë paralel me rrjetin elektrik duhet të jetë pas 2.11.2000. CGJ mund të tregtohen në tri vitet pasuese pas lëshimit të tyre.

CGJ lëshohen për:

a) të gjithë prodhimin vjetor të energjisë elektrike nga hidrocentralet, përveç sasisë që i atribuohet rezervave të pompimit;

b) të gjithë prodhimin vjetor të energjisë elektrike nga hidro (ujore), eolike (era), solare (dielllore), gjeotermale, lëvizjen valore (dallgët), batica dhe zbatica, biomasa dhe biogazi;

c) sasinë e prodhuar të energjisë elektrike që i atribuohet pjesës së biodegradueshme të mbetjeve urbane dhe industriale të cilat digjen brenda centraleve termike;

d) sasinë e prodhimit të energjisë elektrike që i atribuohet burimeve të rinovueshme që digjen në centrale hibride, kur energjia elektrike e prodhuar, e cila i atribuohet burimeve jo të rinovueshme, nuk kapërcen 5% të sasisë së përgjithshme të energjisë elektrike të prodhuar;

e) çdo CGJ është e barabartë me 50 MWh.

2. ERE sipas kërkesave do të lëshojë çdo vit GO për energjinë elektrike realisht të prodhuar nga impiantet, të cilat janë kualifikuar dhe vetëm në rastet se impianti është në punë. GO lëshohet për të njëjtat kategori prodhimi të përmendura më lart për CGJ.

3. ERE do të lëshojë CGJ për një periudhë 12-vjeçare.

4. Sasia e energjisë, për të cilën mund të lëshohet CGJ dhe/ose GO, do të matet ose llogaritet nga matjet. Aplikuesi duhet të paraqesë dokumente të përshtatshme të certifikuara nga autoritetet publike kompetente.

Neni 11

Ndryshime në detajet teknike të regjistruara

1. Prodhuesi duhet të informojë ERE-n për çdo modifikim të ndodhur në centralet prodhuese të energjisë së kualifikuar në përputhje me këtë rregullore.

2. Në rastet e centraleve në ndërtim, qëllimi i komunikimit të sipërpërmendur është të

monitorojë realizimin e impiantit dhe të krahasojë karakteristikat finale teknike të tij me ato të komunikuar fillimisht së bashku me kërkesën për kualifikim.

3. Për impiantet e kualifikuara ende në fazë projekti, menjëherë pas vënies në punë të impiantit, prodhuesi duhet t'i komunikojë ERE-s:

a) çdo modifikim të mundshëm të detajeve teknike lidhur me projektin (p.sh. ndryshime të fuqisë së instaluar, lloji i mbetjeve të përdorura etj.), fillimin e punës në rast të një ndërtimi të ri dhe datën e kolaudimit;

b) datën e fillimit të operimit për llogaritjen e periudhës së marrjes së CGJ-së.

4. Në veçanti, komunikimi në lidhje me datën e operimit të impiantit prodhues për herë të parë paralel me rrjetin elektrik duhet të certifikohet nëpërmjet aktit të kolaudimit të mbajtur në bazë të ligjit nr.8402, datë 10.9.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit", sipas praktikave dhe rregullave të lidhjes në sistemin elektroenergjetik dhe akteve të tjera nënligjore në fuqi.

5. Në rast se modifikimi i përshkruar e bën projektin jo të përputhshëm me legjislacionin, kualifikimi me vendim të Bordit do të anulohet.

Neni 12

Komunikim plotësues për kualifikimin e impianteve prodhuese termike

1. Në rastet kur prodhuesi kërkon GO dhe/ose CGJ vjetore për impiante termike prodhuese (jo hibrid) të ushqyer nga biomasa dhe biogazi, duhet të konfirmojë llojin e lëndës djegëse të përdorur.

2. Çdo modifikim i ndodhur duhet të komunikohet menjëherë nga prodhuesi për ERE-n, e cila do të procedojë në përputhje me legjislacionin në fuqi me verifikimin e të gjitha kërkesave të nevojshme për impiantet për të vijuar me marrjen e GO dhe/ose CGJ.

3. Nëse nuk jepet informacion ose jepet jo i vërtetë e drejta për të marrë GO dhe CGJ humbet për të gjithë prodhimin dhe për të gjithë pjesën e mbetur të periudhës.

4. Kur një prodhues termik (i ushqyer nga mbetjet, biomasa ose biogazi) përdor një lëndë djegëse konvencionale bashkë me burime të rinovueshme ose burime të tjera të pranuar, prodhuesi, kur të kërkojë GO dhe/ose CGJ, duhet të demonstrojë që sasia e energjisë elektrike e prodhuar, e cila i atribuohet lëndëve djegëse, si qymyri, nafta etj., është më e vogël se 5% e prodhimit total.

5. Me këtë qëllim, prodhuesi duhet t'i komunikojë ERE-s çdo vit një vlerësim teknik të prodhimit neto të energjisë elektrike e cila i atribuohet lëndëve djegëse konvencionale të përdorura.

Neni 13

Afatet kohore kufi të aplikueshme

1. Në rastin e impianteve prodhuese të kualifikuara dhe ende jo në operim, kualifikimi do të anulohet nëse prodhuesi nuk i komunikon ERE-s:

a) fillimin e punimeve për ndërtimin e centralit brenda 18 muajve nga data e kualifikimit;

b) fillimin e punës në paralel me rrjetin elektrik brenda 3 vjetëve nga data e kualifikimit.

2. Në të dyja rastet, prodhuesi do të paraqesë një kërkesë të re për t'u kualifikuar sipas procedurave të kësaj rregulloreje.

3. Prodhuesi mund të vonojë paraqitjen e kërkesës për CGJ deri në 18 muaj nga data e operimit të impiantit prodhues për herë të parë paralel me rrjetin elektrik. Në rast se prodhuesi nuk paraqet kërkesën për CGJ pas vonësës së lejuar (18 muaj), periudha 12-vjeçare e aplikimit të CGJ do të fillojë të llogaritet nga muaji i 18 e në vijim.

Neni 14

Llogaritja e energjisë

1. Paragrafët në vijim përshkruajnë llogaritjen e energjisë neto E_{cv} , që përfiton GO dhe/ose CGJ. Energjia e llogaritur nga prodhuesit duhet të jetë në përputhje me tipin e prodhuesit të energjisë dhe të dhënat teknike të përshtatshme. ERE ka të drejtë të verifikojë dhe t'i paraqesë

prodhuesit një vlerësim të ndryshëm të energjisë.

2. Prodhiimi neto i një prodhuesi energjie është prodhiimi bruto, duke zbritur energjinë e marrë për nevojat vetjake dhe humbjet në transformatorët në gjenerim.

3. E gjithë energjia neto, faktikisht e prodhuar nga një prodhues i ri energjie i ushqyer plotësisht nga burime energjie të rinovueshme, përfiton nga GO dhe/ose CGJ.

4. Në rastet e prodhuesve të rinj hibrid, përfiton GO dhe/ose CGJ vetëm pjesa e energjisë që i atribuohet burimeve të rinovueshme.

Pjesa e prodhimit të energjisë elektrike neto mund të llogaritet si në vijim:

$$E_{cvi} = W_{Ren} \times \frac{P_{ci}}{\eta}$$

ku:

E_{cvi} është pjesa e energjisë elektrike neto (kWh) që përfiton GO dhe/ose CG

W_{Ren} është pesha e burimeve të rinovueshme të energjisë (kg)

P_{ci} vlera neto kalorifike (kJ/kg)

η norma mesatare e ngrohjes (kJ/kWh)

Llogaritja e mësipërme aplikohet vetëm në rastet kur energjia elektrike, që i atribuohet burimeve jo të rinovueshme, është më tepër se 5% e totalit.

5. Pjesa e energjisë elektrike, që i atribuohet rezervave të pompimit, nuk përfiton GO dhe/ose CGJ.

Pjesa e prodhimit të energjisë neto që përfiton nga GO dhe/ose CGJ për rastin e centraleve me rezerva pompimi mund të llogaritet si vijon:

$$E_{cv} = E_g - [(E_p \times \alpha)] - E_{AU}$$

ku:

E_{cv} , pjesa e energjisë elektrike neto (kWh) që përfiton GO dhe/ose CG

E_g , energjia totale neto e prodhuar (kWh)

E_{AU} , energjia që marrin stacionet ndihmëse dhe humbjet në transformatorët e gjenerimit (kWh)

E_p energjia e harxhuar nga sistemi i pompimit (kWh)

α efienca totale lidhur me pompimin dhe përdorimin në vazhdim të ujit të pompuar. Vlera e këtij koeficienti për kryerjen e llogaritjeve do të pranohet 0.6-0.7

Neni 15

Inspektimet teknike

ERE, në mënyrë periodike, kryen inspektime në vend në prodhuesit e energjisë për të verifikuar informacionin e dhënë.

Në rastet e deklarimit jo të vërtetë, kualifikimi anulohet dhe çdo e drejtë e lidhur me këtë humbet.

PJESA E TRETË

DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 16

Amendamente të rregullores

1. Këto rregulla janë objekt rishikimi dhe ndryshimi me vendim të Bordit të Komisionerëve të ERE-s, në përputhje me rregullat e praktikës dhe procedurave të ERE-s.

Neni 17
Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi pas publikimit të saj në Fletoren Zyrtare.

KËRKESË

Shtetësja Dhurata Koxhaj, e bija e Azbiut dhe e Lirisë, e datëlindjes 26.1.1973, lindur dhe banuese në Berat, lagja “Çlirim”, kërkon shpalljen të zhdukur të bashkëshortit të saj, Armand Koxhaj.

KËRKUESJA
Dhurata Koxhaj

Abonimet vjetore mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Zhan d'Ark”, prapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", nr.tel: 04 267 468
 Çmimi i abonimit për Fletoret Zyrtare 2006 është 16 000 lekë.

BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

1. KUSHTETUTA E SHQIPËRISË	
2. KODET E LEGJISLACIONIT SHQIPTAR	
3. REGJISTRAT E NOTERISË	
4. PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI:	
1. PËR PROKURIMIN PUBLIK (2006).....	1500
2. PËR NËPUNËSIN CIVIL (2005)	600
3. PËR SISTEMIN E DREJTËSISË (Vëllimi i I-rë dhe vëllimi i II-të-2006).....	1300
4. PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI NË FUSHËN E ARSIMIT.....	500

Botime të reja

1 TREGUESI KRONOLOGJIK I LEGJISLACIONIT-2004 (Vëllimi I).....	1000
2 TREGUESI KRONOLOGJIK I LEGJISLACIONIT-2006 (Vëllimi II).....	500
3 TREGUESI TEMATIK I LEGJISLACIONIT-2004 (Vëllimi I).....	1000
4 TREGUESI TEMATIK I LEGJISLACIONIT-2006 (Vëllimi II).....	500
5 PËRMBLEDHJE MARRËVESHJESH NDËRKOMBËTARE NË FUSHËN E DREJTËSISË.....	1000
6 PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR PUSHTETIN VENDOR.....	800
7 PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR NDËRTIMET.....	500
8 PËRMBLEDHJE VENDIMESH UNIFIKUESE TË GJYKATËS SË LARTË (2000-2006).....	1000
9 PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR SHOQËRITË TREGTARE.....	500

Hyri në shtyp më 2.3.2007
 Doli nga shtypi më 5.3.2007

Tirazhi: 3500 copë	Formati: 60x88/8
--------------------	------------------

Shtypshkronja “Grafon”
 Tiranë, 2007

Çmimi 24 lekë